

SHPRESA DUHET TË JETË BESIM DHE VEPRIM

Gjatë këtij fjalimi do të mbërthej domethënien e imanit të plotfuqishëm të bazuar në ligjin e Allahut të Plotfuqishëm për t'u përmirësuar dhe për t'u rregulluar statusi sipas thënies kur'anore:

“Ai (njeri) ka përcjellës një pas një, para tij dhe prapa tij, që me urdhrin e Allahut e ruajnë atë. All-llahu nuk e prish gjendjen e një populli (nuk ua largon të mirat) për derisa ata ta ndryshojnë veten e tyre. Po, kur All-llahu vendos ta ndëshkojë një popull, atë nuk ka kush që ta zbrapsë. Ata, (njerëzit) nuk kanë mbrojtës tjetër pos Tij.”

(Err-Rraëd, 11)

pikësypnim për ndërtimin e rrugës së përmirësimit dhe rregullimit duke u angazhuar për t'i ikur pesimizmit dhe për të shpresuar fuqishëm në Allahun e Lartmadhëruar, sepse sa më shumë që shtohet besimi në Allahun e Lartmadhëruar, aq më shumë shtohet shpresa në realizimin e premtimit të Allahut për ndihmë, përkrahje, fuqi dhe qeverisje. Për këtë arsye jeta e umetit duhet të ndërtohet mbi shpresën për ardhmërinë e lumtur, duhet të ndërtohet mbi shpresën se e nesërmja është dita e ndihmës, fitores, fuqisë, qeverisjes dhe sundimit të fesë së Allahut të Lartmadhëruar dhe sheriatit të pastër dhe madhështor.

Lus Allahun e Lartmadhëruar që të bëjë dobi nga fjalimi im dhe lus Allahun e Lartmadhëruar që kush e lexon këtë punim ta bëjë hapje të rrugës drejt shpresës në zemrat e muslimanëve dhe angazhim në përmirësimin prej gjendjes momentale në gjendje më të favorshme në gjendje të fuqive, zhvillimit dhe qeverisjes së islamit, dhe muslimanëve. Vërtet Allahu i Lartmadhëruar ka mundësi për çdo send. Ai na mjafton, nuk ka ndihmëtarë më të mirë.

* * *

RREZIKU NGA PESIMIZMI DHE HUMBJA E SHPRESËS

Përkundër të gjitha agresioneve që zhvillohen pa ndërprerë në Palestinë, Bagdad, Afganistan, Çeçeni dhe në vendet tjera islam;

përkundër, torturimit, vrasjeve, dëbimeve permanente ndaj muslimanëve;

përkundër asaj se shumica vazhdimisht me habi pyesin: A është koha që të flasim për shpresë?;

përkundër asaj se shumica veç i kanë humbur shpresat dhe thonë: Ka marrë fund, nuk kemi çka të flasim;

përkundër asaj se shumica thonë: Atë që flitni për Palestinën, Mesxhidi Aksanë është vetëm iluzion dhe mashtrim,se jemi lodhur me fjalë, e asgjë nuk ka ndryshuar, e s'ka dobi!;

përkundër gjithë këtij pesimizmi të umetit them me plot bindje dhe i sigurt se: Tani është koha më e përshtatshme për të folur për shpresë dhe optimizëm. Unë e ndiej obligim që të flas për *shpresë*, për të mbjellë në zemrat e muslimanëve se: Deri sa

mos ta ndryshojnë gjendjen e tyre pozitivisht, duke u angazhuar që ta ndryshojnë gjendjen prej pesimizmit dhe brengave deri te shpresa dhe vetëbesimi.

Them me vendosmëri dhe bindje të thellë:

Duhet ta shtjellojmë çështjen e shpresës sipas planprogramit hyjnor: “Derisa mos ta ndryshojnë veten e tyre (në brendi), posaçërisht në këtë kohë, sepse po e ndiej se umetin e ka kapluar pesimizmi me të madhe, ndërsa pesimizmi është i rrezikshëm.

Prej dukurive që e rrezikon umetin është se:

- Pesimizmi lëkundë besimin dhe bindjen në Zotin e Lartmadhëruar .
- Pesimizmi shkakton lëkundje në besimin e Kadasë dhe Kaderit në zemrat e njerëzve.
- Pesimizmi është armik i shpresës dhe suksesit, armik i fitores dhe shkaktar i dështimit.
- Pesimizmi shtie në përtaci dhe mospunë.
- Pesimizmi e humbë fuqinë e umetit për aktivitet dhe punë.
- Pesimizmi e humbë angazhimin e umetit për te qëllimi final.
- Pesimizmi ia humbë umetit vullnetin dhe dëshirën.
- Populli pesimist dështon gjithmonë.
- Populli pesimist është popull përtac dhe i dështuar.
- Populli pesimist është i shtrirë për toke, askush nuk punon, askush nuk prodhon, askush nuk fiton.
- Populli pesimist është i gjykuar për t’u asimiluar.

Për këtë arsye:

Duhet të flasim për shpresë, duhet të mbjellim shpresë në zemrat e njerëzve, duhet t’u sqarojmë çështjen e shpresës.

* * *

KUPTIMI I SHPRESËS

Çdo anëtar i shoqërisë duhet të kujdeset që zemra e tij të jetë aksionare në ndërtimin e shpresës për një të ardhme më të mirë, të qetë, krenare dhe qeverisje të islamit dhe muslimanëve.

Shpresë do të thotë bindje në Allahun e Lartmadhëruar.
Shpresë do të thotë mirëbesim në Allahun e Lartmadhëruar.
Shpresë do të thotë lutje, përkushtim ndaj Allahut të Lartmadhëruar.
Shpresë do të thotë mëshirë e Zotit ndaj umetit tonë.
Shpresë do të thotë falje gabimesh dhe ngritje të vlerave.
Shpresë do të thotë arritjen e gradës së shehidit në rrugën e Allahut të Lartmadhëruar.
Shpresë do të thotë shpëtim nga Zjarri dhe fitimin e Xhenetit.
Shpresë do të thotë qetësi, lumturi dhe sukses edhe në këtë botë, edhe në botën tjetër.
Shpresë do të thotë pozitivitet dhe punë.
Shpresë do të thotë aktivitet punë dhe prodhim.
Shpresë do të thotë forcë dhe fuqi.
Shpresë do të thotë zhvillim dhe përmirësim i gjendjes; pa shpresë nuk ka as zhvillim, as përmirësim.
Shpresë do të thotë forcë, fuqi dhe fitore.
Shpresë do të thotë jetë të mirë dhe fisnike.
Shpresë do të thotë do të thotë përmirësim i vazhdueshëm i gjendjes tonë.
Shpresë do të thotë rikthim i Palestinës, Mesxhidi Aksasë, rikthim i Irakit dhe rikthim i krenarisë së muslimanëve.
Shpresë do të thotë shkuarje e natës dhe zbardhje e ditës, që do të thotë humbje e errësirës dhe shpërndarje e dritës, do të thotë asgjësim i kriminelëve, uzurpatorëve, tradhtarëve dhe okupatorëve.
Shpresë do të thotë e nesërme e ndritshme, mëngjes fatlum, diell shndritës.
Shpresë do të thotë urim dhe përgëzim.
Shpresë do të thotë ligji i Allahut për islamin, imanin, e ajo gjendet dhe përsëritet vazhdimisht në Kur'an në format "Përgëzoji", "Uroji".
Zoti i Lartmadhëruar thotë:
"Përgëzoji ata të cilët kanë besuar dhe kanë vepruar punë të mira, se për ta (janë përgatitur) ka xhenete nën të cilët rrjedhin lumenj ...".

(El-Bekare, 25)

"... Dhe, përgëzoji durimtarët".

(El-Bekare, 155)

"Dhe, përgëzoji vepërmirët".

(El-Haxh, 37)

"Dhe i përgëzojnë ata, të cilët do të shkojnë pas tyre dhe nuk kanë pasur fatin të jenë së bashku me ta".

(Ali Imran, 170)

"Pra për të dashurit e Allahut (evliatë) nuk ka as frikë, as pikëllim, ata janë (të cilët) kanë besuar dhe i janë frikësuar Allahut, përgëzim për ta, edhe për këtë botë, edhe për botën tjetër, nuk ka ndryshim në fjalët e Allahut, ky është fitim i madh".

(Junus, 62-64)

"Dhe, kur i erdhën Ibrahim, të dërguarit tanë me lajm të mirë, përgëzues".

(Hud, 69)

“Ata, të cilët i janë larguar tagutit (djallit) dhe më nuk e adhurojnë, por i janë kthyer dhe i janë drejtuar Allahut, për ta ka përgëzim, pra përgëzoji robërit (të cilët i janë kthyer Allahut)”

(Zumer, 17)

“Atë ditë fytyrat do të jenë të shndritura, të cilat do të shkëlqejnë, do të jenë të qeshura dhe të përgëzuara”.

Ajetet të cilat flasin për përgëzim janë të shumta ajo fjalë është fjalë burimore e fesë tonë islame dhe duhet të rrënjohet në zemrat tona.

Nëse i bëjmë një vështrim Kur'anit fisionik shohim se çdo pejgamber është përgëzuar për diçka, dhe shohim se përgëzimet më të mëdha janë për fëmijë:

IBRAHIMI a.s.

“Dhe ne e përgëzuam atë me një djalë të urtë”.

(Es-Safat, 101)

GRUAJA E IBRAHIMIT a.s.

“Dhe gruaja e tij, deri sa qëndronte në këmbë (i vjen menstruacioni dhe habitet) dhe ne e përgëzuam për lindjen e djalit Is'hak dhe pas Is'hakut, do t'i lindë nipi Jaëkubi”.

(Hudë, 71)

“Shkoni tek ai me këtë këmishë dhe fërkojani fytyrën e tij me të, se do t'i vjen shikimi, pastaj ejani me gjithë familjen tuaj të gjithë së bashku. Kur arriti karvani, babai i tyre tha: vërtet po e ndiej erën e Jusufit.

Thanë: Për Zotin ti veç je në humbje (mërzinë) e mëhershme.

Dhe në atë moment erdhi përgëzuesi dhe ia fërkoj fytyrën e tij dhe i erdh shikimi.

Tha: “A nuk ju kam thënë juve se unë di nga Allahu atë që ju nuk e dini”.

(Jusuf, 93-96)

ZEKERIJA a.s.

“Vërtet Ne të përgëzojmë me një djalë, e emri i tij do të jetë Jahja”.

(Merjem, 7)

“Oj Merjeme, vërtet Allahu ju përgëzon me një djalë të cilin e ka caktuar të jetë me fjalën e tij (bëhu) dhe emri i tij do të jetë Mesijh, Isa i biri i Merjemes”.

(Ali Imran, 45)

Ndërsa umeti i Muhamedit është përgëzuar për vetë pejgamberin e tyre Muhamedin a.s.. Zoti i Lartmadhëruar tregon nëpërmjet Isa a.s.:

“Dhe (jam) përgëzues për një të Dërguar, i cili do të vjen pas meje, e emri i tij është Ahmed”.

(Es-Saf, 6)

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Vërtet Ne të kemi dërguar ty me të drejtë, për drejtësi përgëzues, tërheqës-vërtetjeje”.

(El-Bekare, 119)

Sikurse e shohim se fjala “përgëzim” ka ndërlidhje të fortë me fenë tonë islame të pastër të pastër, shohim se te ne dhjetë sahabe janë përgëzuar me Xhenet.

Ebu Hurejre r.a. transmeton se Xhibrili i ka ardhur Muhamedit a.s. dhe i ka thënë:

“O i Dërguar i Allahut, një enë me ushqim dhe pije është përgatitur për Hatixhën, merre dhe jepja, e përshëndete me *Selam* prej Zotit të saj dhe prej meje, dhe përgëzoje për Xhenetin, i cili është me të gjitha të mirat ku nuk do të ketë aty dhembje, e as pikëllim”.

(Sahihul Buhari, 3536)

Sikurse shohim se “përgëzimi” ka ardhur në momentet më të veçanta, në momentin e vdekjes Xhabir bin Abdullahu tregon se e ka takuar atë i Dërguari i Allahut s.a.v.s. dhe i ka thënë:

“O Xhabir, çka ke që je i thyer? - O i Dërguar i Allahut, babai im ka rënë shëhid, është vrarë në Luftën e Uhudit, dhe ka lënë fëmijë dhe borxhe. Muhamedi i tha: A dëshiron të të përgëzoj për atë çka i ka ndodhur babait tënd?! – I thash: Po, o i Dërguar i Allahut. – Më tha: Allahu gjithmonë kur ka folur me dikë ka folur pas perdeve, ndërsa babën tënd e ka ringjallur dhe i ka folur drejtpërsëdrejti dhe i tha: O robi Im! Dëshiro, do ta kesh. Ndërsa babai yt i ka thënë: O Zoti Im! Më ringjall që të vritem për Ty. – Ne veç e kemi caktuar herët se kthim prapa s’ka. Ka thënë: Për këtë rast ka zbritur ajeti kur’anor”.

(Tirmidhiu, 2936, hasen garibë. Ibni Maxhe, 186, 2790.

“Sahih el-Xhamië lil alametü Albani”, 7905)

Vëlla!!

Feja jonë është fe e shpresës dhe përgëzim. A e dini domethënien e fjalës “Shpresë”? Në “Muaxhem vexhizë – Shpresë” më së shumti përdoret për rastet kur shumë vështirë është për t’u realizuar.

Pra, shpresa (Emeli) në gjuhën arabe ka për qëllim shtresimin e realizimit të diçkaje për në të ardhmen që vështirë realizohet.

Unë me ju jam duke diskutuar çështjen e shpresës, posaçërisht në momentet kur shumica mendojnë se shumë larg është çështja e daljes së muslimanëve nga kriza. Pra duhet të mbjellim shpresë në zemrat e njerëzve, sepse kësaj radhe shpresa nuk është çështje e cila vështirë realizohet, ajo realizohet, por me një kusht: “Të vepruarit me planprogramin e Allahut të Lartmadhëruar”:

“Derisa mos ta ndryshojnë pozitivisht gjendjen e tyre”.

(El-Enfalë, 53)

Shpresa është obligim, apo jo?

Pa dyshim se shpresa është farz, sepse është çështje e besimit të çdo muslimani.

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Dhe mos e humbni shpresën në Allahun, vërtet shpresën në Allahun nuk e humb kush, pos pabesimtarëve”.

(Jusuf, 87)

Vëllezër!!

Ne jemi duke folur për farzin e çdo muslimani. Vërtet Allahu i Lartmadhëruar kur ka krijuar krijesat mbi ta ka lëshuar një pjesë të mëshirës prej 100 pjesëve të mëshirës së Tij me të cilën mëshirohen njerëzit, ndërsa 99 pjesë i ka rezervuar në Vete për Ditën e Kijametit.

Ebu Hurejre r.a. transmeton se e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut s.a.v.s. duke thënë:

“Allahu e ka përpjesëtuar mëshirën në 100 pjesë dhe një pjesë e ka zbritur në tokë, e prej asaj pjese mëshirohen njerëzit derisa edhe kali e heq këmbën nga i vogli i saj me frikë se do ta lëndoje”.

(Sahih El-Buhari, 5541)

Mirëpo, pse Allahu të ndalë 99 pjesë të mëshirës së Tij për në ditën e Kijametit?! Që dera e shpresës së mëshirës së Tij të jetë e hapur për robërit e Tij gabimtarë, që të pendohen dhe të shpresojnë në mëshirën e tij dhe kurrë mos ta humbin shpresën. Allahu nuk dëshiron që robi i Tij t'i humbë shpresat, sepse kjo është pabesim.

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Dhe mos e humbni shpresën në Allahun, vërtet shpresën në Allahun nuk e humb kush pos pabesimtarëve”.

(Jusuf, 87)

Për të qenë dera e shpresës e hapur, Zoti Lartmadhëruar thotë:

“Zoti i Juaj e ka caktuar që Ai Vetë të jetë i mëshirshëm”.

(El-En'amë, 54)

Për të qenë dera e shpresës e hapur, Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Mëshira Ime ka përfshirë çdo gjë”.

(El-Earafë, 156)

Për të qenë dera e shpresës e hapur, Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Mëshira Ime ka prioritet nga dënimi Im”.

(Muslimi, 4940)

Vëllezër!!

Të gjithë ne së bashku duhet të shpresojmë në ndihmën e Allahut për këtë fe. Për këtë kurrë nuk duhet ta humbim shpresën, dhe kurrë nuk duhet të dyshojmë. Nëse në këtë dyshojmë jemi në rrezik. Pesimizmi nuk është cilësi e besimtarit, por është çështje e pabesimtarëve dhe hipokritëve.

Vëlla!! Përgëzohu për Allahun e Lartmadhëruar.

Gjithmonë mbaje shpresën në Allahun e Lartmadhëruar.

Kurrë mos e humb shpresën në udhëzimin e Allahut robërit e Tij muslimanë. Kurrë mos e humb shpresën në ndihmën e Allahut të Lartmadhëruar për këtë fe.

Mendo vetëm të mirën në Allahun e Lartmadhëruar.

Ke besim të plotë në Allahun e Lartmadhëruar.

PEJGAMBERI a.s. MBJELLË SHPRESË NË ZEMRAT E SAHABËVE

Pejgamberi s.a.v.s. gjithmonë është angazhuar për mbjelljen e shpresës në Allahun e Lartmadhëruar te Sahabët r.a., deri sa edhe në momentet më të vështira, sepse ai prej tyre dëshironte imanë të fortë dhe të palëkundur. Ai i ka edukuar dhe i ka strukturuar me imanë të fortë, të cilët kanë qenë gjenerata e shkëlqyeshme pas pejgamberëve.

Vëlla!!

Besimtarit sa më shumë që i ngushtohen çështjet atij më shumë i rritet shpresa në Allahun e Lartmadhëruar. Ndërsa, ai i cili nuk është besimtar i vërtetë kur t'i ngushtohet çështja i rritet pesimizmi dhe dëshpërimi. Zoti na ruajt nga ajo gjendje.

Hipokriti është larg Allahut, ai vetëm i përcjellë interesat e tij, prej tij nuk ka dobi. Ndërsa besimtari është i ndërlidhur për Allahun e Lartmadhëruar, ai nuk humbë kurrë.

Në këtë parim i ka edukuar Pejgamberi s.a.v.s. sahanët, i ka edukuar në mbështetje vetëm në Allahun e Lartmadhëruar, i ka edukuar në shpresë në Allahun e Lartmadhëruar, bindje dhe besim në Allahun fuqiptotë.

Adij Hatemi r.a. transmeton se:

“Kur kam kuptuar se do të vjen i Dërguari i Allahut, e kam urryer për së tepërmi takimin me të. Kam shkuar në anën e romakëve deri te Kajseri, mirëpo edhe aty e kam urryer pozitën time më shumë se sa të takohem me të Dërguarin e Allahut. Pastaj jam ndalur një çast dhe e kam pyetur veten: *“Për Zotin, po pse të mos e takoj atë njeri (Muhamedin a.s.)?! Nëse është rrenacak nuk mund të më dëmtojë. Nëse është besnik do ta kuptoj besnikërinë e tij”*. Për këtë arsye kam shkuar dhe e kam takuar. Kur kam hyrë aty njerëzit brohoritën: Adij bin Hatemi, Adij bin Hatemi!

Pastaj vazhdon duke treguar Hatemi: Hyra te i Dërguari i Allahut s.a.v.s., e ai më tha: O Adij bin Hatem! Prano Islamin, do të jesh i shpëtuar, këtë e përsëriti tri herë. I jam përgjigjur: Por unë kam fenë time. Ai më tha: Unë fenë tënde e di më mirë se ti. I thashë: Ti të dish për fenë time më mirë se unë?! – Ai tha: Po. Mirë, a nuk je prej rukusijëve, ndërsa ti merrë një të katërtën e bagëtive të popullit tënd. I thash: Po. – Ai tha: Në fenë tënde kjo është e ndaluar. Deri sa e tha këtë, pastaj vazhdoi: Unë e di edhe çka të pengon për ta pranuar islamin. Sepse ti mendon dhe thua: Si t’i pasoj njerëzit e dobët dhe ata të cilët nuk kanë forcë dhe fuqi, ata i kanë larguar arabët. Por, a di ti për sunduesin më të madh persian. – I thash: Kam dëgjuar për të, por asnjëherë nuk e kam takuar. – Ai tha: Për Zotin, në dorën e të Cilit është shpirti im, Allahu do ta plotësojë urdhrin e Tij, sa që gruaja prej Persisë do të udhëtojë për të shkuar në haxh pa përcjellje dhe nuk do ta lëndojë askush dhe do të çlirohet perandoria e Kisra bin Hermezit. – I thash: Kisra bin Hermezit?! – Tha: Po, Kisra bin Hermezit dhe do të shpërndani pasuri sa të dëshironi, por askush nuk do të ketë nevojë dhe askush nuk do ta pranojë.

Pastaj tregon Adij bin Hatemi, për atë kohë: Ja sot gruaja udhëton prej Persisë deri në Qabe për ta kryer haxhin pa kurrfarë përcjellje dhe pa kurrfarë rreziku. Unë kam qenë ai kur është çliruar kështjella e Kistrasë bin Hermezit”.

Për Zotin në dorën e të Cilit është shpirti im ju do të jeni përsëri ata që do ta keni forcën sepse i Dërguari i Allahut s.a.v.s. e ka thënë këtë.

Vëlla!! Adiju r.a. pranoi Islamin me shpresë se Islami ka ardhmëri dhe pjesëtarët e tij kanë fitim edhe në këtë botë, edhe në botën tjetër me bindje të plotë në Allahun, po ti a e ke këtë shpresë?

Ne jemi umet i caktuar për fisnikëri dhe triumf, nëse pasojmë shkaqet dhe i mbështetemi vetëm Allahut dhe askujt tjetër.

Suraka bin Xhuëshem transmeton se:

“Deri sa isha në një takim (vendtubim) të fisit Beni Medlexh, një njeri prej tyre m’u afrua dhe në heshtje më tha: O Surak, pak më parë pashë një pikë (shenjë) të zezë, e cila ecte në shkretëtirë, mendoj se është Muhamedi me shokun e vet”. I kam kuptuar se ata janë, por ia kam ndryshuar mendjen, duke i thënë se ata janë filani dhe filani, të

cilët janë njerëzit tanë”. Në atë vendtubim kam ndenjur edhe një çast apo pak kohë, pastaj kërkova leje dhe dola jashtë. Robëreshën, e cila ka qenë e caktuar të më shërbejë, e urdhërova të ma përgatis kalin dhe ta dërgonte prapa bregores. Pastaj kam marrë shtizën time dhe dola nga dera e prapme e shtëpisë, duke ecur në maje të gishtërinjve që të mos më gjurmë prapa. Kur kam arritur te kali, i hipa dhe u nisa me shpejtësi dhe i kam arritur. Gjatë rrugës, kali mori në thua dhe më rrëzoi për toke. U ngrita dhe i mora në qesen time shtizat e fallit, i hodha dhe e kapa njërën, kur shigjeta e fallit ishte që mos ta vazhdoj rrugën se do të më godas e keqja. Por, unë i hipa kalit, nuk e përfilla fallin (shortin) dhe vazhdova rrugën me shpejtësi. Kur, papritmas kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut duke kënduar Kur'an, i qetësuar dhe pa shikuar djathtas e majtas, ndërsa Ebu Bekri ishte i kujdesshëm dhe ende lëvizte kokën anash, djathtas e majtas. Në ato çaste kali im u fundos me këmbët e përparme të tij në tokë deri në gjunjë. Zbrita nga kali, dhe e ngrita. Ai posa doli prej toke prapë u fundos, dhe kur tentoi përfundimisht të dilte prej toke, kur papritmas gufoi rëra, pluhuri i së cilës u ngrit lartë si tym. I mora shigjetat e fallit i hodha, dhe e mora njërën, përsëri shorti (falli) ishte që mos ta vazhdoj rrugën dhe detyrën që e kisha marrë, se do të më godas e keqja.

Atëherë fillova të kërkoj ndihmë duke bërëtitur me tërë fuqinë që kisha. Ata më premtuan siguri. Kali im shpëtoi nga rëra e gjallë. Unë i hipa dhe iu afrova atyre. Mendoja me vete se i Dërguari i Allahut s.a.v.s. e di se dëshiroja t'i zë andaj i thashë: “Populli yt ka caktuar shpërblim për atë, i cili të kap të gjallë. Unë i kam dhënë shënime për ty dhe për rrugën tënde. Ju kam përgatitur pajisje dhe ushqim ...”. Dhe kështu flisja e flisja kur ai më tha: “Largohu prej nesh!”. Atëherë e luta të ma shkruaj një fletë garantuese. I Dërguari i Allahut e urdhëroi Amir b. Fuhejres dhe ai ma shkroi në një pjesë lëkure. Pastaj i Dërguari i Allahut s.a.v.s. vazhdoi rrugën e tij”.

(Sahihul Buhari)

Omer bin Hatabi r.a. transmeton se, kur ia kam dhënë Surakës rrobat, shpatën dhe kapelën e Kistrasë, i ka veshur Suraka bin Malik bin Xheashem dhe ka thënë: “Falënderoj Allahun, i Cili ia mundësoi të veshë rrobat e Kistrasë një arabi beduin”.

Shafiiju thotë: “Vërtet i ka veshur Suraka, sepse Pejgamberi s.a.v.s. i ka thënë Surakës, pasi ia shikoi duart e tij: Po shoh sikur ti i ke të veshura rrobat e Kistrasë. Vallahu Ealem”.

(“El Bidaje ve Nihaje ibni Kethiri”, 6/201)

Vëlla!!

Kjo është shpresa të cilën e ka përjetuar Suraka r.a., ndërsa edhe ju duhet të keni ndonjë shpresë për të cilën duhet të jetosh që të kesh ambicie që ta forcosh shpirtin.

Berra bin Azibi transmeton se:

“Kur na ka urdhëruar i Dërguari i Allahut s.a.v.s. për të hapur hendeqe (istikame), në një vend ku ishim ne, u paraqit në mes të hendekut një gurë i madh të cilin nuk mund ta eliminonim. Shkuam dhe ia treguam të Dërguarit të Allahut s.a.v.s.. Atëherë erdhi i Dërguari i Allahut s.a.v.s. e vendosi rrobën e tij, u ngjit mbi gur, e mori mjetin thyerjes e tha: BISMILAH dhe i ra me të fortë dhe e theu një të tretën e gurit, e pastaj tha: Allahu Ekber, mu dhanë çelësat e Sirisë. Për Zotin unë nga ky vend po i shoh kështjellat e tij. Pastaj tha: BISMILAH dhe i ra për së dyti dhe e theu prapë një të tretën e gurit, e tha: Allahu Ekber, mu dhanë çelësat e Persisë. Për Zotin unë po i shoh

qytetet, po i shoh kështjellat e bardha nga këtu. Pastaj tha: BISMILAH! dhe i ra edhe për të tretën herë dhe e theu gurin në tërësi e tha: Allahu Ekber, mu dhanë çelësat e Jemenit. Për Zotin po i shoh dyert e Sanasë nga ky vend ku jam”.

(Musnedi Imam Ahmedit, 17946)

Vëlla!!

Shiko se si ka mbjellë i Dërguari i Allahut s.a.v.s. shpresë për të ardhmen e mirë, për islamin, muslimanët në shpirtrat e sehaveve dhe si i ka edukuar ata në kohërat më të vështira, sa që armiku iu kishte vështirësuar dhe furnizimin me ushqim!

Ajo ka qenë shpresa se kjo fe do të fitojë.

Ajo ka qenë bindja në Allahun e Lartmadhëruar dhe imani i ngulitur në Allahun e Lartmadhëruar.

A e ke ti këtë shpresë në Allahun e Lartmadhëruar?

Ky është ushqimi i kësaj bote dhe i botës tjetër nëse e do ti këtë ushqim.

Gruaja e Muhamedit a.s., Aishja r.a. transmeton se i Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë: E kam pyetur të Dërguarin e Allahut s.a.v.s.: A ke përjetuar ditë më të vështirë se në ditën e Uhudit? Ai mu përgjigj: Po, ditën më të vështirë e kam përjetuar prej popullit tënd, bile më të vështirë se në Akabe. Kam shkuar dhe iu kam lajmëruar Ibni Abdi Jalil bin Abdul Kelal dhe ai nuk më është përgjigjur, dhe pasi jam larguar nga aty, i mërzitur dhe i pikëlluar, dhe pasi kam arritur në vendin Thealib, e kam ngritur kokën time, kur shoh se retë më kanë mbuluar me hije. Shikova lart, kur pash Xhibrilin, i cili më thirri dhe më tha: Vërtet Allahu i Lartmadhëruar ka sjellë te ti Melekun e kodrave që ta urdhërosh çka të dëshirosh, për t’i dënuar ata. Tregon Aijsha se Meleku i kodrave e ka thirrur të Dërguarin e Allahut s.a.v.s., i ka dhënë selam dhe i ka thënë: O Muhamed, vërtet Allahu ka dëgjuar fjalët e popullit tënd. Unë jam jeleku i kodrave; Zoti yt më ka dërguar që të veprosh sipas urdhrit tënd, nëse dëshiron do t’i bashkoj këto dy kodra dhe do t’i zhduki ata në tërësi! Ndërsa i Dërguari i Allahut s.a.v.s. i ka thënë:

“Jo, përkundrazi, sepse unë kam shpresë se prej mesit të tyre Allahu do të nxjerrë disa të cilët do ta adhurojnë Allahun të Vetmin, dhe kurrë nuk do t’i bëjnë shok Atij”.

(Buhariu, 2992)

Shejh Uthejmini r.a. për këtë thotë: Shiko për shpresën në jetën e të Dërguarit të Allahut s.a.v.s. dhe vizionin e tij (largpamësinë) në kohët më të vështira në rrethana më të vështira, dhe çfarë shpresë ka pasur në Zotin e Lartmadhëruar.

Vëlla!!

A e ke edhe ti këtë ndjenjë, dhe a keni edhe ju shpresë të tillë!!

* * *